



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.87, datë 12.07.2021

PËR
MIRATIMIN E ZGJIDHJES SË DETYRËS SË PROJEKTIMIT TË PROJEKTIT ME
OBJEKT “STUDIM E PROJEKTIM TË REHABILITIMIT TË INFRASTRUKTURËS
SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN PORTO ROMANO – KËNETË DHE
SISTEMIMI RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË
QYTETIT DURRËS”

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fakeqësisë natyrore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.775, datë 30.09.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për Hartimin e Projektpreventivit dhe Riforcimin e Hidrovorit të Durrësit” i ndryshuar me VKM Nr.213, datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për hartimin e studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, Urdhërit Nr.253, datë 19.04.2021, nr.4929 prot, datë 19.04.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) si dhe për llogaritjen e fondit limit për proçedurën e prokurimit me objekt: “Hartimin e studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e zgjidhjes së detyrës së projektimit të projektit me objekt “Studim e projektim të rehabilitimit të infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën Porto Romano – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit Durrës” sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.07.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

RELACION

**PËR MIRATIMIN E ZGJIDHJES SË DETYRËS SË PROJEKTIMIT TË
PROJEKTIT ME OBJEKT “STUDIM E PROJEKTIM TË REHABILITIMIT TË
INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN PORTO ROMANO
– KËNETË DHE SISTEMIMI I RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN
URBANE TË QYTETIT DURRËS”**

Baza ligjore: Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019, Për përballimin e pasojave të fakeqësisë natyrore”, Vendimit 775 datë 30.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për Hartimin e Projektpreventivit dhe Riforcimin e Hidrovorit të Durrësit” i ndryshuar me VKM nr.213 datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për hartimin e studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, Urdhërit nr.253 datë 19.04.2021, nr.4929 prot datë 19.04.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) si dhe për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: “Hartimin e studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, Detyrës së projektimit për hartimin e këtij projekti, Relacionit të dërguar nga grupi i punës drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike Bashkia Durrës mbi miratimin e zgjidhjes së detyrës së projektimit të projektit me objekt “Studim e projektim të rehabilitimit të infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën Porto Romano – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit Durrës”

Në vijim të Vendimit 775 datë 30.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, nga Bashkia Durrës, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për Hartimin e Projektpreventivit dhe Riforcimin e Hidrovorit të Durrësit” i ndryshuar me VKM nr.213 datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për hartimin e studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, u ngrit grupi i punës sipas Urdhërit nr.253 datë 19.04.2021, nr.4929 prot datë 19.04.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) si dhe për llogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: “Studim projektimit për

rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”.

Në zbatim të këtij Urdhëri grupi i punës ka hartuar detyrën e projektimit duke përcaktuar se investimi themelor do të përcaktohet nga zgjidhja më e mirë e miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Përsa më sipër ju kërkohet të miratoni zgjidhjen e detyrës së projektimit të objektit “Studim projektimit për rehabilitimin e infrastrukturës së rrjetit të kulimit në zonën e Porto Romanos – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”, në zbatim të relacionit të hartuar nga grupi i punës për këtë qëllim, sipas materialit të mëposhtëm.

Zgjidhja e miratuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr.253 datë 19.04.2021 nr.4929 prot


Në këtë zgjidhje gjurma e kanalit të ri do të fillojë devijimin në pjesën ku kanali ekzistues merr kthesën 90 gradë dhe më pas do të ndjekë gjurmën e kanalit sekondar deri në takimin me kanalin kullues të Sektorit Rina.

Më pas kanali kthehet në krahun e majtë në drejtim të fillimit të kodrës së Bishtit të Pallës përgjatë gjurmës së kanalit ekzistues kullues deri në takimin me rrugën ekzistuese më pas do të kthehet presëri me një kënd rreth 25 gradësh në drejtim të kodrës. Godina e Hidrovorit do të vendoset në fillim të kodrës në një terren gjysëm shkëmborë dhe pa prani të ujrave nëntokesore. Shkarkimi në det do të bëhet me anën e kanalit përkatës që do të kalojë në gjurmim me thellësi mesatare 12.0 m, në forme U-së .



Pika e shkarkimit e zgjedhur është në skajin verior te Portit të ri dhe është në nje zonë të detit me thellësi relativisht të madhe që ka dhe një vetpastrim me të madh të ujit të detit.

Gjithashtu duhet të theksojme që në këtë zgjidhje godina është me e sigurtë dhe kostoja dhe koha e ndërtimit është relativisht e vogël .



Në gjurmën që do të përdorim, toka është inproduktive pasi ka prezencë të madhe të kriprave.

Kjo gjurme nuk ka ndikim të madh në ambient pasi do të përdorim gjurmet pjesërisht të hapura të kanaleve ekzistues .

Kostoja e zgjidhjes

Në bazë të çmimeve referuese dhe të tregut kostoja e punimeve për këtë zgjidhje që përfshin devijimin nga kanali kryesor deri në venderdhje është :

**PREVENTIV PARAPRAK PER REHABILITIMIN E KULLIMIT TE ZONES SE PORTOROMANOS DHE ZONES
URBANE DURRES
(ZGJIDHJA)**

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
SPOSTIMI I HIDROVORIT DHE REHABILITIMI I RRJETIT TE KULLIMIT					
1	Zgjatimi i kanalit kryesor kullues	m ³	74,337	420	31,221,540
2	Germim ne shkemb per kanal in e shkarkimit	m ³	21,000	1,680	35,280,000
3	Ndertimi I veprave te artit (ura tombino)	leke	1	300,000,000	300,000,000
4	Sistemimi dhe transporti I dherave te germuar	m ³	95,337	350	33,367,950
5	Ndertimi I Godines se Hidrovorit	m ²	860	184,500	158,670,000
6	Vendosja e pompave te hidrovorit	leke/kË	2,844	104,160	296,281,017
7	Ndertimi I linjes elektrike	leke	1	250,000,000	250,000,000
8	Sistemimi I godines	leke	1	25,000,000	25,000,000
Shuma					1,129,820,507.25
Fondi rezerve 10 %					112,982,050.73
Shuma					1,242,802,557.98
T.V.SH 20 %					248,560,511.60
Shuma Totale (ALL)					1,491,363,069.57
Shuma Totale (Euro)					12,075,814.33

Në këto kosto do të shtohet dhe kosto e shpronësimeve të ndërtesave që prishen të cilat duhen vlerësuar.


Me miratimin e kësaj zgjidhje Bashkia Durrës do të aplikojë pranë Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin për miratimin e fondeve të përcaktuara, pas depozitimit në Bashki të projekt zbatimit dhe marrjes së opinionit teknik nga Instituti i Ndërtimit, për të vijuar më tej procedurat e prokurimit publik mbi zbatimin e këtij projekti.

**DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE
INFRASTRUKTURËS PUBLIKE**

Adnand Toçila

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Ardian Iljazaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 511/prot.

Durrës, më 12.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 87 datë 12.07.2021 Për miratimin e zgjidhjes së detyrës së projektimit të projektit me objekt “Studim e projektim të rehabilitimit të infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën Porto Romano – Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

